

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM
NDËRMJET
AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
DHE
KOMISIONIT PËR INDUSTRIJË E UJIT TË
SKOCISË

AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT (ARRU) DHE KOMISIONI PËR INDUSTRIJË E UJIT TË SKOCISË (WICS), (Palët), duan që të promovojnë interesat e përbashkëta për aspektet e rregullimit të menaxhimit të furnizimit me ujë dhe sistemit të kanalizimit;

Palët e shohin nënshkrimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi si një angazhim për të punuar së bashku në disa fusha për një të ardhme të parashikueshme. Palët do të ndajnë përvojën dhe informacionin lirshëm me qëllim që të përmirësojnë qasjen e tyre ndaj rregullimit ekonomik.

Janë pajtuar që të bashkëpunojnë si më poshtë:

1. Shkëmbimi i informacionit

Palët do të ndajnë informata relevante që kanë interesa të përbashkëta siç janë: politikat rregullatore; monitorimin e performancës dhe zhvillimin e raporteve të performancës; metodologjinë e përcaktimit të tarifave dhe planeve të menaxhimit të aseteve; dhe në çdo fushë tjetër ku palët besojnë se mund të kenë vlerë. Shkëmbimi i këtij informacioni dhe përvoja do të kontribuojë në zhvillimin e ekipeve të palëve.

Palët pranojnë se mund të ketë disa kufizime në informacionin që mund të ndahet. Ata, në çdo kohë, do të respektojnë konfidencialitetin e informacionit që u është ndarë atyre.

2. Implementimi i marrëveshjes

Drejtori i ARRU dhe Kryeshefi Ekzekutiv i WICS do të jen përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi. Kjo përgjegjësi mund të delegohet tek anëtarët tjerë të institucioneve.

3. Resurset

Të dyja palët do të mbulojnë shpenzimet e tyre në lidhje me bashkëpunimin sipas kësaj marrëveshje,.

4. Implementimi

Edhe nëse lindin probleme në interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, palët do të bien dakord se si t'i zgjidhin ato më së miri përmes një dialogu konstruktiv.

Nënshkruar në Prishtinë, e enjte 08 Mars 2018	Nënshkruar në Prishtinë, e enjte 08 Mars 2018
Për ARRU	Për WICS
Raif Preteni, Drejtor	Alan D A Sutherland